



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit , dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2022 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TREVJEQAR PËR BANIM 2022-2025 TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET , Programi trevjeqar për banim 2022-2025 i Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Programi trevjeqar për banim 2022-2025 i Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Arsyetim

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë Vendim e cila ka shërbyer si bazë për hartimin e Programit Komunal trevjeqar për banim 2016-2019 është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për financimin e programeve të veçanta të

banimit Nr.03/L-164 të datës 25 shkurt 2010, si dhe Statuti i Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Programi Komunal i banimit si dhe vetë Ligji për financimin e Programeve të veçanta të banimit ka për qëllim krijimin e kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimi i mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit.

Programi për banim i Komunës së Lipjanit mbulon periudhën 2022-2025. Komisioni ka përgaditur propozimet për projektet prioritare zbatimi i të cilave rezulton në arritjen e synimeve zhvillimore të përcaktuara në fushat kyqe, detyrimet akviteve, bartësit kryesor, afatin kohor të implementimit, përgaditjes dhe koordinimit të aktiviteteve të përgjithshme për implementimin e projekteve.

Programi i banimit i Komunës së Lipjanit ka qenë në shqyrtim publik dhe i publikuar në Webfaqen e Komunës 15 ditë si dhe poashtu është organizuar një debat publik ku është bërë prezentimi i këtij Programi nga ana e Komisionit i cili ka hartuar Projektin e këtij Programi. Në kuadër të Programit janë përfshirë edhe komentet e publikut.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 011/01-48384
Lipjan, 07.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS


Imri Ahmeti





Programi trevjeçar për banim i Komunës së Lipjanit

2022-2025



Korrik 2022

LLOJI I DOKUMENTIT: PROGRAMI PËR BANIM I KOMUNËS SË LIPJANIT 2022-2025

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

VENDIMI: Nr 1 Nr 360-61095, datë 17.12.2020

KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM - LIPJAN

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në Komision
1	Hanushe Berisha	DPUMM	Kryesues
2	Albert Mustafa	DSHMS	Anëtar
3	Lumniye Ejupi	SPJ	Anëtare
4	Lorik Berbatovci	QPS	Anëtar
5	Fatmit Goliqi	ZKK	Anëtare
6	Driton Tafallari	VoRAE	Ekspert i jashtëm

Përmbajtja

PJESA E PARË – TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	5
HYRJE	5
VIZIONI	5
QËLLIMI I PROGRAMIT	6
KORNIZA LIGJORE	6
DOKUMENTET E TJERA RELEVANTE	7
PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT	7
VENDIMET SHITESË PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT	8
STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR	8
PJESA E DYTË: PROFILI I KOMUNËS SË LIPJANIT	8
POZITA GJEOGRAFIKE	9
SHFRYTËZIMI I TOKËS	9
DEMOGRAFIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL	10
RASTET SOCIALE	12
PAPUNËSIA	Err
or! Bookmark not defined.	
BANIMI, SHPËRNDARJA E LOKALITETEVE	Err
or! Bookmark not defined.	
VLERËSIMI PËR KËRKESAT NË TË ARDHMEN	Err
or! Bookmark not defined.	
PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA	13
PJESA 3: PROGRAMI I BANIMIT	14
ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL	14
FAMILJET E NDIHMUARA PËRMES BANESAVE SOCIALE	Error! Bookmark not defined.
FAMILJET TË NDIHMUARA PËRMES BONUS BANIMIT	Error! Bookmark not defined.
FAMILJET E NDIHMUARA PËRMES NDËRTESAVE KOMUNALE TË	
ADOPTUARA PËR BANIM SOCIAL	Error! Bookmark not defined.
FAMILJET E NDIHMUARA PËRMES RENOVIMIT TË SHTËPIVE EKZISTUESE	Error! Booki
FAMILJET E NDIHMUARA PËRMES RINDËRTIMIT TË SHTPËIVE TË REJA	Error! Bookma

KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL	16
GJENDJA E KOMUNITETEVE LIDHUR ME ÇËSHTJEN E BANIMIT	16
KATEGORITË E SYNUARA	16
KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË	17
GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE	17
PLANIFIKIMI PËR BANIM PËR TRE VITET E ARDHSHE	19
NDËRTIMI I NJË NDËRTESE PËR BANIM SOCIAL ME 16 NJËSI BANESORE.....	19
SIGURIMI I BANIMIT PËR 27 FAMILJE PËRMES BONUS BANIMIT	21
Mënyra e implementimit të skemave për Bonus Banim	21
Forma e parë – përzgjedhja direkte e përfituesve;.....	21
Forma e dytë – përzgjedhja e përfituesve me thirrje publike	22
OFRIMI I NDIHMËS PËRMES RIPARIMIT TË SHITËPIVE EKZISTUESE PËR 30 FAMILJE	22
Banimi individual	22
PËRFUNDIMI I PROCESIT TË NDARJES SË BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE PËRMES KONKURSIT PUBLIK ME QIRA JOPROFITABILE	23
IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT.....	23.
CAKTIMI I ZYRTARIT PËR BANIM.....	23
NDARJA E BUXHETIT PËR BANIM SOCIAL	24
Viti 2021	24
Viti 2022	24
Viti 2023	255
PËRMBLEDHJE E NEVOJAVE BUXHETORE	25
REZULTATET PAS ZBATIMIT	25
Instrumentet e mbikqyrjes	26
Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve	26
Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor	26
Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparençës	26
ANALIZA SË OT	27

PJESA E PARË – TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Në vijim do të prezantohen të dhënat e përgjithshme që lidhen me përpilimin e programit tre vjeçar për banim të komunës së Lipjanit.

HYRJE

Programi Trevjeçar për banim i komunës së Lipjanit i prezantuar në këtë dokument është pasues i programit që ka mbuluar vitet 2016-2019 ku janë për bazë të arriturat dhe sfidat gjatë realizimit të programit të skaduar. Sipas ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (Ligji nr. 03/L – 164) Komunitatet e Kosovës, e me këtë edhe komuna e Lipjanit duhet të merret me sigurimin e banimit për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi për sigurim të kulmit mbi kokë për vete dhe për familjet e tyre. Banimi është çështje vendimtare për një stabilitet shoqëror, shëndet të mirë dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore. Vlen të theksohet se e drejta e banimit është njëra ndër të drejtat elementare të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut si dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Pra, me miratimin e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, ofrohet një kornizë e avancuar për autoritetet vendimmarrëse lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Edhe komuna e Lipjanit në programet e saj zhvillimore ka për qëllim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj, pasi që ka hapësirë për të përmirësuar jetën e qytetarëve në nevojë për banim të përkohshëm.

Hartimi i Programit për banim social 2022-2025, do të mundëson kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë vështirë të e bëjnë një gjë të tillë.

Ky dokument, pra Programi Trevjeçar për Banim social, do të mundësojë trajtimin e çështjeve kyçe të identifikuar, siç janë mungesa e banimit adekuat, përkeqësimi i banimit ekzistues, etj. Pas këtij programi me punën aktive të zyrtarëve të Lipjanit priten të bëhen ndryshime dhe do të krijohet baza ligjore për zgjidhje më të qëndrueshme

VIZIONI

Komuna e **Lipjanit** të jetë një vend me kapacitete gjithëpërfshirëse të ndërtimit dhe banimit, atraktiv dhe mbështetës për kategori të caktuara, me një popullsi aktive dhe nivel të lartë të kualitetit të jetës dhe kulturës për të gjitha komunitetet.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i këtij programi është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike që vetë ta zgjidhin problemin e banimit. Do të ndihmohen me banim adekuat të gjithë qytetarët e Lipjanit pa dallim etnie.

KORNIZA LIGJORE

Programi Trevjeçar për Banim është bazuar në legjislaturën si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-164, dt.04.2010 për financimin e programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira jo profitabile, Nr.10/2010 dt.2.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e bonusit të banimit, Nr.19/2010-dt.02.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, Nr.22/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për normat e banimit për programet e veçanta të banimit, Nr.24/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit, Nr.23/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Nr.21/2010, dt. 18.11.2010;
- Ligji 04/L-134 të ndërtesës në bashkëpronësi, dt.06.09.2013;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dt.19.06.2008;
- Ligji nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dt.27.01.2012;
- Ligji nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-247
- Statuti i Komunës;
- Dokumentet planore – urbane;
- Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, 05/L-031, dt.21.06.2017.

- Ligji nr.06/L-026 për Azil;
- Rregullorja (QRK) nr.09/2019 për Integrimin e të Huajve

DOKUMENTET E TJERA RELEVANTE

Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;

Plani Zhvillimor Komunal (2013 – 2023);

Programi Trevjeçar për Banim 2016-2019;

Plani Lokal për Personat e Riatdhesuar

Plani Lokal për Kthim të Qëndrueshëm

Strategjia për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptas

PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT

Në vijim është prezantuar organogrami i përpilimi të programit trevjeçar për banim:




Figura 1:Organogrami

METODOLOGJIA PËR PËRPILIM TË PROGRAMIT

Vendimet shtesë për përpilim të Programit Trevjeçar për Banim janë si në vijim:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Lipjanit datë 17.12.2020, për përgatitjen e Projektit të Programit të Veçantë për Banim në Komunën e Lipjanit për Periudhën 2022-2025;
- Sigurimi i të dhënave nga fushat përkatëse të Komunës (Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes, Qendra për Punë Sociale, Zyra lokale për Komunitete, dhe drejtoritë tjera përkatëse). Për momentin Komuna e Lipjanit nuk i ka të vendosura të dhënat e përfituesve në softuerin e Bazës së të Dhënave. Kjo duhet të bëhet gjatë implementimit të këtij programi trevjeçar për banim. Për këtë qëllim komuna e Lipjanit do të kërkojë ndihmë nga Divizioni për banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).
- Identifikimi i grupeve të synuara;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë bazuar në gjendjen faktike të çështjes së banimit;
- Struktura e Buxhetit Komunal në Lipjan;
- Përgatitja e dokumentit;
- Konsultimet me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës -(MMPHI) – Divizioni për banim, ;
- Bërja publike e Programit Trevjeçar të Banimit) – informimi-konsultimi publik;
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës;

Në përpilim të programit ka ndihmuar edhe OJQ VoRAE.

STRATEGJITË E NIVELIT QEVERITAR

-
- Strategjia Kombëtare për Ri-integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2018-2022.
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim.

PJESA E DYTË: PROFILI I KOMUNËS SË LIPJANIT

Në vijim janë të prezantuara disa informata bazike lidhur me komunën e Lipjanit. Të dhënat janë marrë kryesisht nga Plani Zhvillimor Komunal 2013 – 2023.

Motoja e komunës:

“LIPJANI PORTË E KOMUNIKIMIT DREJT BOTËS: VENDI KU E TAKONI LASHTËSINË DHE VLERAT E KOSOVËS”

POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike sepse gjendet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Gjilan dhe Artanë.

Në Komunën e Lipjanit jetojnë rreth 57,605 banorë, në qytetin e Lipjanit jetojnë rreth 10,000 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale (fshatra). Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës dhe mbulon sipërfaqen prej 338.47 km². Dendësia e popullsisë 169.59 b/km², ndërkaq dendësia mesatare e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km², 3.2% e territorit të shtetit.

Pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë (89 %), ndërsa (6 %) janë serb, kroatë (1 %), romë (1%) dhe 2.9% të tjerë. Moshë e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 -65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç. Mesatarja e madhësisë së familjeve është pesë anëtarë.

Ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor – hekurudhor e përmes Vrellës edhe atij ajror, për shkak se Aeroporti i vetëm ndërkombëtarë gjendet në territorin e Komunës së Lipjanit dhe është nga qendra vetëm 15 km. Në anën perëndimore shtrihet rezervati Blinaja që do të mund të zhvillohej në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin, në vendbanimin Gadime gjendet Shpella e mermerit që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit por për tërë Kosovën. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva po ashtu konsiderohet si vend atraktiv për vizitorë.

Kjo makro-pozitë e territorit të Komunës si dhe e vetë qytetit Lipjan paraqet rrethanën mjaft të përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të Komunës. Përmes territorit të Komunës së Lipjanit kalon hekurudha e cila lidhë këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi.

Komuna e Lipjanit ka 62 fshatra, ku numër më i madh i tyre janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës që paraqet pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit, ndërsa vendbanimet e tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjik-pjesëve kodrinore malore të Komunës së Lipjanit, ku një numër i tyre është i koncentruar në pjesën qendrore ndërsa të tjerat në pjesën lindore dhe perëndimore të kufijve morfologjikë – pjesëve kodrinore malore të Komunës, gjithashtu kjo Komunë gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të qendrave më të mëdha të Republikës së Kosovës

SHFRYTËZIMI I TOKËS

Në përgjithësi rreth 60% e popullatës në Komunën e Lipjanit merren me bujqësi, dhe një pjesë bukur e madhe e popullatës jeton në mërgim ku edhe krijon të hyra të mjaftueshme për disa

familje. Tokat pjellore shtrihen në pjesën e rrafshët të komunës, rreth lumenjve dhe përrockave dhe kryesisht shfrytëzohen për bujqësi, me një trend të rritjes së shndërrimit të tokave pjellore në ato ndërtimore dhe sipërfaqe të pa mbjella (djerrina). Në këtë aspekt mungojnë hulumtime përkatëse për kualitetin dhe shfrytëzimin e tyre.




Figura 2: Shpërndarja e tokës – 63% tokë bujqësore dhe 37% lloje tjera të tokës

DEMOGRAFIA DHE ZHVILLIMI SOCIAL

Në Komunën e Lipjanit jetojnë rreth 57,605 banorë, në qytetin e Lipjanit jetojnë rreth 10,000 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale (fshatra). Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës, dhe mbulon sipërfaqen prej 338.54 km². Dendësia e popullsisë 170 b/km², e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km², 3.2% e teritorit të shtetit.

Pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë (89 %), ndërsa (6 %) janë serb, kroatë (1 %), romë (1%) dhe 2.9% të tjerë. Moshë e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 -65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç. Mesatarja e madhësisë së familjeve është pesë anëtarë.

Madhësia e familjeve/ madhësia dhe numri i vendbanimeve (banesa).

Ka paqartësi sa i përket madhësisë mesatare të familjeve në Lipjan. Madhësia e familjeve në qytetin e Lipjanit parashihet të jetë më e vogël se ajo e komunës si tërësi, me shumicë të popullsisë që jeton në fshatrat rurale në përgjithësi në Kosovë. Madhësia relativisht më e vogël e familjeve të zonave urbane në krahasim me zonat rurale që është matur në vitin 2002 pak a shumë edhe është vërtetuar me hulumtimin demografik në vitin 2003. Madhësia e familjes në atë hulumtim është vlerësuar në 6.4 persona në Kosovë, 6.8 në zonat rurale dhe 5.5 në zonat urbane.

Përbërja e familjeve nuk është e kufizuar vetëm për prindër dhe familje; ka familje që jetojnë së bashku me tri gjenerata dhe anëtarë tjerë të familjes që mund të jenë të integruar poashtu. Pasi që të rinjtë prej 16 deri 24 vite janë pa punë të rregullt në një masë të madhe, mund të thuhet se ata ekonomikisht janë të lidhur në familjet e prindërve të tyre. Në të ardhmen madhësia mesatare e familjeve do të pakësohet edhe më tutje, sa më e fuqishme dhe në rritje të jetë ekonomia aq më tepër kushtet ekonomike posaçërisht për grupmoshat 16 deri 30 vjeç do të përmirësohen. Poashtu balansi i migrimit që është një faktor në kërkesat për banim është fort i lidhur me zhvillimin ekonomik.

Pasi që nuk ka të dhëna në dispozicion për rezerva të banimit në Lipjan, psh. as për numrin e as për sipërfaqen e vendbanimeve, të dhënat e mëtutjeshme për hapësirë për banim për kokë banori janë bazuar në të dhëna që janë vlerësuar më herët në Prishtinë.

Treguesi i zhvillimit njerëzor

Komuna	Lipjani	Prishtina	Kosova
Jetëgjatësia	70	71	69
Arsimi	91	96	94
Regjistrimi në shkollë	89	91	88
Të ardhurat për kapital	1,180	1,586	1,053
Treguesi i jetëgjatësisë	0.76	0.77	0.73
Treguesi i arsimimit	0.89	0.94	0.92
Treguesi i të ardhurave	0.41	0.46	0.39
Treguesi i zhvillimit njerëzor	0.69	0.72	0.68

Figura 3. Treguesi i zhvillimit njerëzor

Treguesi i zhvillimit njerëzor është një kombinim i treguesit të jetëgjatësisë, treguesit të arsimimit dhe treguesit të të ardhurave. Kjo llogaritje për herë të parë është aplikuar nga UNDP në vitin 2004 ku ka dalë se Kosova ka treguesin e zhvillimit njerëzor në koeficientin prej 0.68 ku janë marr

parasysh treguesi i jetëgjatësisë prej 0.73, treguesi i arsimimit prej 0.92 dhe treguesi i të ardhurave prej 0.39 dhe nga këta koeficientë ka rezultuar se Kosova renditet në mesataren e vendeve me zhvillim mesatar njerëzor. Bazuar në këto burime të UNDPsë Lipjani është pak mbi mesataren e Kosovës, por mjaft larg nga disa qytetet Evropiane apo edhe të Ballkanit.

RASTET SOCIALE

Nacionaliteti	Nr. Familjeve	%	Nr. Anëtarëve	%
- Të tjera -	2	0.09%	7	0.13%
Ashkali	151	13.77%	798	14.31%
Boshnjak	2	0.26%	4	0.07%
Egjiptian	2	0.24%	7	0.13%
Kroat	8	0.82%	30	0.54%
Rom	25	1.60%	109	1.96%
Sërb	10	0.92%	34	0.61%
Shqiptarë	1021	82.29%	4586	82.26%
TOTAL:	1221		5575	

Sipas Qendrës për Punë Sociale (QPS-së), në Lipjan janë të regjistruar 1,276 familje në skema sociale që marrin ndihmë. Ky numër është një indikator i rëndësishëm për komisionin e krijuar për përpilimi e Programit Trevjeçar për të planifikuar numrin familjeve për tu ndihmuar në tre vitet e ardhshme me banim social.

Struktura nacionale e familjeve dhe e anëtarëve të familjes në SNS , VITI 2020

Nacionaliteti	Nr. Familjeve	%	Nr. Anëtarëve	%
- Të tjera -	1	0.06%	6	0.10%
Ashkali	147	12.75%	759	13.26%
Boshnjak	1	0.09%	2	0.03%
Egjiptian	2	0.22%	7	0.12%
Kroat	8	0.78%	28	0.49%
Rom	28	1.65%	122	2.13%
Sërb	13	1.28%	43	0.75%
Shqiptarë	1070	83.16%	4757	83.11%
TOTAL:	1270		5724	

Nacionaliteti	Nr. Familjeve	%	Nr. Anëtarëve	%
Të tjera	2	0.09 %	7	0.13%
Ashkali	151	13.77 %	798	14.31%
Boshnjak	2	0.26 %	4	0.07%
Egjiptian	2	0.24 %	7	0.13%
Kroat	8	0.82 %	30	0.54%
Rom	25	1.60 %	109	1.96%
Sërb	10	0.92 %	34	0.61%
Shqiptarë	1021	82.29 %	4586	82.26%
TOTAL:	1221		5576	

Struktura nacionale e familjeve dhe e anëtarëve të familjes në SNS , VITI 2021

Ndërsa për tre vitet e fundit numri i familjeve në skemë sociale është si në vijim:

Viti	Numri i familjeve
2021	1308
2020	1270
2019	1221

Tabela 2: Numri i familjeve në skemë sociale në tre vitet e fundit

PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA

Bazuar në Planin Rregullues Urban (PRrU) këto janë informatat bazike për komunën e Lipjanit:

Nr.	Zonat - territori i mbuluar me plane urbane	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e zonës me PU	Raporti %
-----	---	-------------------	--------------------------	-----------

		Komunës /ha		
1.	Qyteti i Lipjanit dhe rrethina e ngushte me PRRU, PZHK, PZHU	13,422	13,422 ha	100%
2.	Vendbanimet PRRU	13,422	1,531 (zona urbane)	11.40%
3.	Vendbanimet PZHK dhe PZHU	13,422	13,422	100%

Tabela 7: Informatat bazë për planifikimin hapësinor dhe infrastrukturorë

PJESA 3: PROGRAMI I BANIMIT

Në vijim do të bëhet një prezantim i programit të banimit për tri vitet e ardhshme duke filluar nga analiza e programit të skaduar trevjeçar për banim e duke vazhduar më programet e veçanta për banim sipas ligjit. Komisioni është përkujdesur që programi të jetë konkret dhe i zbatueshëm duke prezantuar numrin e familjeve që duhet të ndihmohen në tre vitet e ardhshme, mënyrën e ndihmës përmes programeve të veçanta për banim të prezantuara në ligj si dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e këtij programi.

ANALIZË E PROGRAMIT TË SKADUAR PËR BANIM SOCIAL

Programi i prezantuar është vazhdim i programit të cilit i ka kaluar afati. Sipas programit të kaluar për banim 2016-19 janë parapa pesë programe për banim. Në vijim do të prezantohet gjendja aktuale lidhur me çështjen e banimit në komunën e Lipjanit:

Programi 1:

Përshkrimi: Ndërtesa të banimit kolektiv që ndërtohen në pronësi të komunës dhe me PPP, një pjesë e të cilave jepen me kontratat qiraje – qira jo profitabile për kategori të ndryshme (Qyteti i Lipjanit, Grackë e Vjetër, Rubovc, Janjevë dhe Magurë)

Realizueshmëria: Nuk është realizuar për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe mungesës së buxhetit të planifikuar

Programi 2: li

Përshkrimi: Objektet e dala jashtë funksionit si rezultat i mbylljes së ndonjë veprimtarie, të cilat mund të adoptohen në funksion të banimit për programet e veçanta të banimit, të cilat janë në

pronësi të komunës apo në pronësi tjetër shoqërore që mund t'i u ndërrohet destinimi (Objektet ekzistuese në Magurë)

Realizueshmëria: Nuk është realizuar për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe mungesës së buxhetit të planifikuar

Programi 3:

Përshkrimi: Banesa ekzistuese në pronësi të komunës të cilat do të klasifikohen nga autoritetet kompetente si banesa për programe të veçanta për banim që mund të jepen me kontratë qiraje jo profitabile dhe të subvencionuar për familjet që fitojnë bonus banimi (objektet në ndërtim, 2 objekte ku rreth 30% e banesave janë në pronësi të komunës)

Realizueshmëria: Kjo pjesë është realizuar pjesërisht. Janë ndarë 21 njësi banesore me qira joprofitabile për familje në nevojë për banim të përkohshëm. Përzgjedhja e familjeve është bërë përmes komisionit komunal të krijuar për këtë çështje.

Programi 4: Ndërtimi i objekteve në blloqet urbanistike të planifikuara për banim kolektiv, do të jepen me qira jo profitabile. Ndërtimi i objekteve në pronësi komunale apo private me bashkëfinancim, ku autoritetet komunale mund të marrin pjesë me hartimin e dokumenteve planore dhe pajisjen e lokacionit me infrastrukturë dhe menaxhimin, apo forma tjera lehtësuese duke krijuar partneritet me subjektet private apo donatorë. Kjo vjen në shprehje edhe në rastet e shpronësimit, legalizimit dhe vendbanimeve jo formale dhe ndarja e banesave (sipërfaqes së ndërtimit) bëhet në raport me vlerën financiare të pjesëmarrjes.

Sigurimi i banimit dhe rregullimi për vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje – për VBJ hartimi i PRRU, rehabilitimi i tyre dhe sigurimi i banimit në rastet të cilat ndikohen nga planet.

Legalizimi i ndërtimeve pa leje bazuar në ligjin për legalizim dhe definimi i kushteve rreth mundësisë së shfrytëzimit të banesave për program të banimit.

Realizueshmëria: Nuk është realizuar.

Programi 5:

Përshkrimi: Realizimi i projekteve për përmirësimin e kushteve të banimit në objektet ekzistuese të banimit kolektiv dhe individual në bashkëpunim me pronarët sipas bazës ligjore – bashkëfinancim përmes sektorit të banimit apo subjekt i kontraktuar i licencuar për këtë veprim.

Realizueshmëria:

Për familjet e riatdhesuara janë ndërtuar 12 shtëpi dhe janë rinovuar 5 shtëpi. Ky proces ka zgjatur që nga viti 2010. Familjet e ndihmuara i takojnë të gjitha komuniteteve.

Për familjet e kthyera janë ndërtuar 9 shtëpi në vitin 2019. Këto shtëpi janë financuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tash me emërtimin e ri Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve. Familjet e ndihmuara u takojnë të gjitha komuniteteve.

Për familjet të etnitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas janë ndërtuar 13 shtëpi gjatë vitit 2019, të financuara nga MPMS me emërtimin e tanishëm MFPT.

OJQ VoRAE ka bërë renovimin e mbi 70 shtëpive për komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

OJQ "Jetimat e Ballkanit" ka ndërtuar 10 shtëpi për familjet në gjendje të rëndë socio ekonomike.

KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL

Në komunën e Lipjanit në vazhdimësi vijnë kërkesa për ndihmë për banim. Kërkesat bëhen përmes formularëve komunalë. Këto kërkesa shqyrtohen nga zyrtarë komunal nga drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe nga Zyra për Komunitete dhe Kthim. Kërkesat kanë të bëjnë kryesisht me nevoja për renovime dhe riparime në shtëpi të vjetra apo të dëmtuara. Komuna e Lipjanit i viziton këto familje dhe në bazë të buxhetit në dispozicion dhe në bazë të nevojave të qytetarëve e bën shpërndarjen e ndihmave.

Për momentin në komunën e Lipjanit janë të evidentuara 68 familje të cilat kanë nevojë për ndihmë në banim. Nga ky numër 10 familje kanë kërkuar ndihmë për banim social (nuk kanë pronë të vet) ndërsa familjet tjera kanë kërkuar renovim apo rindërtim të shtëpive në pronë private. Të gjitha këto familje janë të evidentuara dhe gjatë implementimit të programit të prezantuar do të regjistrohen në softueri për banim social. Meqenëse informatat e prezantuara nga aplikuesit për banim social nuk mjaftojnë që të regjistrohen në data bazë, duhet të kërkohej nga të gjithë aplikantët që të sjellin informatat shtesë ashtu që të mundësohet regjistrimi. Do të kërkohej ndihmë nga MMPHI – divizioni për banim që të ofrojnë trajnim për përdorim të data bazës.

GJENDJA E KOMUNITETEVE LIDHUR ME ÇËSHTJEN E BANIMIT

Në komunën e Lipjanit jetojnë rre 3,000 familje të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Siç e cek më lartë deri më tani komuna e Lipjanit dhe donatorë tjerë kanë ndihmuar rreth 20 familje me ndërtim apo renovim të shtëpive kryesisht të financuara nga OJQ VoRAE të cilët kanë renovuar mbi 70 shtëpi. Informatat më të hollësishme për këto shtëpi i ka në dispozicion kjo OJQ.

KATEGORITË E SYNUARA

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen :

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;

- Kategoritë e dala nga lufta dhe ish të përndjekurit politik;
- Të kthyerit;
- Personat me status të mbrojtjes ndërkombëtare në Kosovë (refugjatët, personat me mbrojtje plotësuese, me mbrojtje të përkohshme dhe personat me status të pashtetësisë);
- Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas;
- Të riatdhesuarit;
- Të moshuarit;
- Të rinjtë;
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror;
- Nënata vetushqyese-kryefamiljare;

KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:

- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave;
- Gjendja shëndetësore;
- Invaliditeti;
- Struktura e familjes;

GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE

KOMUNA E LIPJANIT		
Nr. i popullsisë		57,605
Zonat rurale		50,632
Zonat urbane		6,842
Nr. i fshatrave/nr i lagjeve		62
Banimi	Nr. objekteve para 1999	9,545

individual	Nr. objekteve pas 1999		3,237
	Etazhiteti mesatar		P+1
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. Objekteve	18
		Nj. Banimi	333
	Pas 1999	Nr. Objekteve	33
		Nj. Banimi	653
	Etazhiteti mesatar		P + 3, P+5, P+8
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]			7.4%
Kryje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]			70%
Nr. i objekteve të pabanuara			43
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim			/
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]			30%
	Mbindërtimet		/
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit			/
Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit			Rreth 3 ha
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët (shtëpi individuale)			150
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qirasë			17
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut			/
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që duhet të rinovohen			4

Qendrat përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	2
	Vendndodhja /emërtimi	Magure
	Nr. i familjeve	32
	Nr. i banorëve	150
Planet e reja		HZK e miratuar

PLANIFIKIMI PËR BANIM PËR TRE VITET E ARDHSHE

Programi për banim i Komunës së Lipjanit është hartuar për periudhën 2022-2025. Komisioni i formuar nga ana e kryetarit të komunës me ndihmën e OJQ VoRAE ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e komunës së Lipjanit që nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë.

Duhet të konstatohet që në Komunën e Lipjanit ka mjaft hapësirë për përmirësimin e ndihmës për familjet në nevojë për banim social gjë që synohet të bëhet me këtë program.

Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare do të vazhdohet me analiza për të emëruar zyrtarin e banimit në kuadër të Komunës së Lipjanit i cili i mungon komunës sonë.

Pra, Programi i prezantuar Trevjeçar për Banim i ka katër programe:

- P1. Ndërtimi i një ndërtese për Banim Social me 20 njësi banesore;
- P2. Sigurimin e banimit për 27 familje përmes skemës së Bonus Banimit, dhe
- P3. Ofrimi i ndihmës përmes riparimit të shtëpive ekzistuese për 20 familje;
- P4. Përfundimi i procesit të ndarjes së banesave në pronësi shoqërore , përmes qirasë joprofitabile edhe për 10 familje sipas procedurave ligjore të konkursit publik

P1. NDËRTIMI I NJË NDËRTESE PËR BANIM SOCIAL ME 20 NJËSI BANESORE

Një ndër prioritetet kryesorë të këtij programi është që në periudhën tre vjeçare komuna e Lipjanit të ketë në pronësi të vet edhe një ndërtesë për nevojat e Banimit Social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Trevjeçare për Banim (03/L-164). Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira jo profitabile,

Megjithatë siç u përmend edhe më lartë për momentin kanë aplikuar rreth 70 familje në nevojë për banim social, nga kjo derivon se komuna e Lipjanit ka nevojë për një ndërtesë të tillë.

Parcela për këtë ndërtesë është e planifikuar të jetë në Zonën kadastrale Magurë, Grackë e Vjetër apo Medvec.

Mesatarja e njësive banesore propozohet të jetë rreth 65 m² prandaj një kalkulim i përafërt i vlerës për ndërtimin e kësaj ndërtese është si në vijim:

$$65 \text{ m}^2 \times 20 \text{ njësi banesore} = 1,300 \text{ m}^2$$

$$1,300 + 10\% \text{ për hapësirat e përbashkëta} = 1,430 \text{ m}^2$$

$$1,430 \text{ m}^2 \times 280 \text{ €/m}^2 \text{ (vlera e përafërt investive)} = 400,000.00 \text{ €}$$

Pra vlera e përafërt investive llogaritet të jetë rreth 400,000 Euro

Kjo ndërtesë planifikohet të ndërtohet brenda dy viteve 2023/24.

Për këtë qëllim Komuna e Lipjanit duhet t'i ndajë 20% të vlerës investive pra rreth 80,000 Euro ndërsa vlera tjetër prej 80 % o të kërkohet nga Qeveria e Kosovës.

P2. SIGURIMI I BANIMIT PËR 27 FAMILJE PËRMES BONUS BANIMIT

Një formë tjetër me të cilën komuna e Lipjanit planifikon të ndihmojë familjet në nevojë për banim social është përmes banesave ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit.

Në këtë formë Komuna e Lipjanit planifikon të ndihmojë 27 familje në tri vitet e ardhshëm.

Në vitin 2022-23 do të ndihmohen 7 familje. Meqenëse për vitin 2022 nuk ka të planifikuar buxhet të veçantë për këtë qëllim, atëherë për këto 7 familje propozohet që buxheti të sigurohet nga fondi për subvencione apo linja tjera buxhetore.

Buxheti i nevojshëm për tri vitet në vijim është si vijon:

Viti 2023: 8 muaj (Maj – Dhjetor 2021) x 100 €/muaj x 7 familje = 5,600 Euro;

Viti 2024 12 muaj x 100 €/muaj x 10 Familje = 12,000 Euro;

Viti 2025 12 muaj x 100 €/muaj x 10 Familje = 12,000 Euro;

Në total kërkohen 29,600 Euro/tri vite

Kjo formë e ndihmës do të paguhet e tëra nga buxheti Komunal.

Për vitin 2022 sigurimi i mjeteve për Bonus Banim do të bëhet nga linja buxhetore për subvencione ndërsa për vitet 2023 dhe 2024 do të krijohet një nën-kod i ri buxhetor për banim i cili kod do të krijohet nën kodin ekzistues për çështje sociale.

Për këtë do të kërkohet ndihmë nga MEA dhe Ministria e Financave. Krijimi i këtij nën-kodi si dhe zotimi i mjeteve për realizimin e këtij programi do të iniciohet në pjesën e dytë të vitit 2022 atëherë kur fillojnë planifikimet buxhetore për vitin 2023.

Mënyra e implementimit e skemave për Bonus Banim

Për përzgjedhjen e përfituesve për t'u ndihmuar me Bonus Banim propozohen dy forma.

Forma e parë – përzgjedhja direkte e përfituesve;

Kjo mund të bëhet nga lista e familjeve të cilat aplikojnë për ndihmë pa thirrje publike por në mënyrë natyrale të shtyrë nga nevoja për sigurim të banimit.

Në këto raste zyrtari për banim e bën një listë të ngushtë duke i vendosur të dhënat e aplikuesve në Data Bazë. Familjet të cilat i plotësojnë kriteret për të përfituar Banim Social vizitohen nga një komision komunal i propozuar nga zyrtari për banim.

Pas përzgjedhjes së përfituesve, nënshkruhet kontratë me ofruesin e banesës me qira.

Përzgjedhja e ofruesve të banesave me qira bëhet sipas ligjit. Format e kontratës gjenden në Udhëzime Administrative.

Mënyra direkte e përzgjedhjes së përfituesve rekomandohet sidomos për vitin 2022 kur në Komunë veçse gjendet një numër i kërkesave për Banim Social.

Forma e dytë – përzgjedhja e përfituesve me thirrje publike

Për të ndihmuar familjet në nevojë për banim social, në fillim të vitit, komuna e Lipjanit do të shpall konkurs. Përmes konkursit do të përzgjidhen për t'u ndihmuar një numër i caktuar i familjeve në vit. Për këto raste do të vendos komisioni i krijuar për këtë qëllim i udhëhequr nga zyrtari për Banim.

Edhe në këto raste aplikantët vendosen në Data Bazë, krijohet lista e përfituesve potencial që i plotësojnë kriteret dhe vizitohen në terren.

Kontratat do të lëshohen më së shumti një vjeçare dhe familjet do të duhet të aplikojnë për çdo vit.

P3. OFRIMI I NDIHMËS PËRMES RIPARIMIT TË SHTËPIVE EKZISTUESE PËR 20 FAMILJE

Një formë mjaft e qëndrueshme për të ndihmuar familjet në nevojë për banim është përmes ofrimit të ndihmës në riparim të shtëpive ekzistuese. Me aprovimin e këtij programi nga kuvendi komunal i Lipjanit, i jepet dritë e gjelbër drejtorisë së financave që të sigurojë mjetet financiare për këtë formë të ndihmës.

Kjo formë e ndihmës nënkupton ndihmë materialë në vlerë rreth 2,000 euro për familje në nevojë që të riparojnë shtëpitë e tyre qoftë të damtuara apo për shkak të pamundësisë financiare që të kompletojnë shtëpitë e tyre. Ndihma mund të jepet për renovim të toaleteve, kulmit, vendosjes së dyerve e dritareve nevojave tjera.

Në këtë mënyrë planifikohet që të ndihmohen rreth 20 familje në dy vitet e fundit të këtij programi, Pra në total për dy vite do të ndihmohen 20 familje.

Vlera e nevojshme për realizimin e kësaj objektive është:

$$10 \text{ përfitues} \times 2 \text{ vite} \times 2,000 \text{ euro} = 40,000 \text{ euro}$$

Përzgjedhja e përfituesve bëhet përmes thirrjes publike e cila duhet të menaxhohet nga zyrtari për banim dhe nga një komision i krijuar për këtë qëllim.

Banimi individual

Komuna e Lipjanit do të vazhdoj komunikimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen/rinovohen shtëpi individuale. Edhe kjo është formë e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje.

Komuna e Lipjanit do të ofrojë informatat relevante dhe do të inicojë programe në këtë drejtim.

P4. PËRFUNDIMI I PROCESIT TË NDARJES SË BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE PËRMES KONKURSIT PUBLIK ME QIRA JOPROFITABILE

Me Programin Komunal trevjeqar për banim 2016-2019, janë ndarë 21 njësi banesore me qira joprofitabile për familje në nevojë për banim të përkohshëm. Përzgjedhja e familjeve është bërë përmes konkursit publik nga ana e komisionit komunal të krijuar për këtë çështje konform dispozitave të legjislacionit në fuqi mirëpo kanë mbetur të lira edhe 10 njësi banesore të cilat për shkaqe teknike nuk ishin të gatshme për tu ndarë në atë periudë.

Përfundimi i këtij procesi planifikohet të vazhdojë me Programin e ri trevjeqar 2022-2025 ku këto njësi banesore do të ndahen për familjet në nevojë me qira joprofitabe përmes konkursit publik konform dispozitave ligjore të legjislacionit në fuqi.

IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

Komisioni për përpilimin e këtij programi ka qenë mjaft i kujdesshëm që programi të jetë konkret dhe i zbatueshëm. Në këtë drejtim na ka ndihmuar mjaft përvoja e ekspertit të angazhuar nga organizta VoRAE të cilët na kanë dhënë mjaft këshilla të vlefshme.

Programi është konkret dhe i zbatueshëm sepse prezanton numra konkretë të familjeve që planifikohet të ndihmohen brenda tri viteve si dhe është bërë kalkulimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e këtij programi.

Programi do të ketë vështirësi në zbatim nëse nuk caktohet një zyrtar për banim, i cili u përmend disa herë gjatë përshkrimit të objektivave të këtij programi.

Po ashtu një pjesë shumë me rëndësi e programit ashtu rivlerësimi nëse familjet që banojnë në ndërtesa sociale vazhdojnë të plotësojnë kushtet për të qëndruar në këto ndërtesa sociale. Kjo do të bëhet nga komision komunal krijuar enkas për këtë qëllim.

CAKTIMI I ZYRTARIT PËR BANIM

Komuna e Lipjanit duhet të caktojë një zyrtar i cili në përshkrimin e vendit të punës do të ngarkohet edhe me trajtimin e çështjes së Banimit Social.

Disa nga detyrat e planifikuara të këtij zyrtari propozohen si në vijim:

- Informimi i qytetarëve lidhur me planet komunale për Banim Social;
- Ofrimi i formularëve adekuat për familjet që kanë nevojë të aplikojnë për Banim Social;
- Vendosja e emrave në Data Bazë;
- Krijimi i listës së ngushtë;

- Inicimi i krijimit të komisionit për përzgjedhje të përfituesve;
- Draftimi i kontratave me përfitues;
- Përcjellja e gjendjes së përfituesve;
- Propozimi i buxhetit të nevojshëm për implementimin e këtij programi. Buxheti duhet të propozohet për çdo vit kalendarik në periudhën e planifikimeve buxhetore vjetore komunale;
- Raportimi për ecurinë e implementimit të programit kuvendit komunal;

NDARJA E BUXHETIT PËR BANIM SOCIAL

Ky program rrezikon të mbetet i pazbatuar nëse nuk planifikohet buxhet i caktuar për Banim Social.

Meqenëse ky program është për tri vite, ndarja e buxhetit propozohet si në vijim:

Viti 2021

Për vitin 2022-23 planifikohet të ndihmohen 7 familje me Bonus Banim (pagesë të gjysmës së qerasë për familje në nevojë për banim të përkohshëm).

Brenda vitit 2022 mund të bëhet përzgjedhja e 7 familjeve përfituese të Bonus Banimit.

Për këtë qëllim nevojiten 5,600 Euro. Meqenëse buxheti për vitin 2022 është veçse i planifikuar, propozohet që këto mjete të ndahen nga linja buxhetore për subvencione apo ndonjë linjë tjetër në dispozicion.

E njëjta vlen edhe për renovimin e shtëpive ku pritet që brenda vitit 2022-23 të ndihmohen 10 familje me këtë metodë ku nevojiten 20,000 euro nga buxheti komunal.

Viti 2022

Për vitet në vijim duhet të planifikohet krijimi i një nën-kodi të veçantë buxhetor si pjesë e kodeve për çështje sociale.

Kjo duhet të bëhet në pjesën e dytë të vitit 2022 kur fillojnë planifikimet buxhetore për vitin 2023.

Për vitin 2023 buxheti i nevojshëm është si në vijim:

Për bonus banim nevojiten 12,000 euro për t'i ndihmuar 10 familje me Bonus Banim;

Për renovim të shtëpive nevojiten 20,000 euro për t'i ndihmuar 10 familje, dhe

Për ndërtimin e ndërtesës për Banim Social gjatë vitit 2023 duhet të ndahen nga komuna e Lipjanit një vlerë prej 40,000 Euro ndërsa nga Qeveria e Kosovës do të kërkohen 160,000 Euro apo në forma tjera të implementimit përmes PPPsë apo donatorëve tjerë.

Viti 2023

Edhe për vitin 2024 vlera e planifikuar buxhetore do të jetë e njëjtë si për vitin 2023. Pra, për bonus banim planifikohen 12,000 Euro për ti ndihmuar 10 familje.

Për renovim të shtëpive novojitën 20,000 euro për ti ndihmuar 10 familje, dhe

Për ndërtimin e ndërtesës për Banim Social gjatë vitit 2023-24 duhet të ndahen nga komuna e Lipjanit një vlerë prej 40,000 Euro ndërsa nga Qeveria e Kosovës do të kërkohen 160,000 Euro.

PËRMBLEDHJE E NEVOJAVE BUXHETORE

Buxheti i nevojshëm për këtë program duhet të parashihet gjatë planifikimeve buxhetore vjetore komunale. Përmbledhja e nevojave buxhetore në formë tabelare për vite është si në vijim:.

	2023	2024	2025	Totali
Komuna e Lipjanit për Bonus Banimi	5,600 €	12,000 €	12,000 €	29,600 €
Komuna e Lipjanit për renovim të shtëpive	0	20,000 €	20,000 €	40,000 €
Komuna e Lipjanit për Ndërtesë Sociale	0	40,000 €	40,000 €	80,000 €
Qeveria e Kosovës për ndërtesë sociale	0	160,000 €	160,000 €	320,000 €
			Totali	469,600 €

Pra në total për implementimin e programit trevjeçar për banim nevojiten 469,600 euro nga të cilat mjete komuna e Lipjanit duhet t'i ndajë 169,600 euro ndërsa do të kërkohet ndihmë nga Qeveria e Kosovës në vlerë 320,000 euro. Rreth 10% e përfituesve duhet të përfshihen komunitetet Serbë, Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

Në këtë mënyrë do të ndihmohen në total 67 familje

REZULTATET PAS ZBATIMIT

Programi për Banim është hartuar në mënyrë që të mund të zbatohet, të matet dhe të monitorohet. Monitorimi është një tipar i domosdoshëm për shkak se a i siguron që veprimet janë

zbatuar dhe se përpjekjet janë duke u bërë për të siguruar përshtatjen me ndryshimet në burimet e disponueshme dhe të nevojshme.

Pas përfundimit të çdo projekti në mënyrë transparente do t'i komunikohet publikut.

Instrumentet e mbikqyrjes

Përgjegjës për realizimin e këtij programi është DSHPS. Kësaj drejtorie do t'i raporton zyrtari për banim social që planifikohet të emërohet si pjesë e këtij programi.

Zyrtari për Banim Social ka për detyrë që të zhvillojë aktivitetet e mirëmbajtjes, implementimin e programit të banimit dhe zhvillimin e programeve duke përcjellë dhe analizuar çështjet e banimit.

Instrumentet e garantimit të realizueshmërisë së programeve

Burimet njerëzore:

Autoritetet kompetente: DSHPS përmes zyrtarit për Banim Social ka për detyrë të raportojë për të gjitha aktivitetet në fushën e banimit, në çdo 6 muaj Kuvendit të Komunës.

Të përcjellin të gjitha të dhënat lidhur me mundësitë e financimit nga programet e ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare.

Të planifikojnë buxhetin krahas buxhetit komunal dhe burimeve të tjera relevante nga fusha e banimit. Të përcjellin-monitorojnë situatën në vazhdimësi të banorëve të cilët janë pjesë e këtyre programeve. Dhe të tjera, varësisht nga zhvillimet në komunë, mundësitë e bashkëpunimit ndër-komunal për raste specifike.

Masat që janë marrë për respektimin e kuadrit ligjor

Kjo pjesë do të jetë në vazhdimësi pjesë e punës së autoriteteve komunale për të cilat do të zbatohet monitorimi dhe auditimi .

Përfshirja e publikut në procesin e sigurimit të transparencës

Publiku si sovran i Komunës , do të ketë të drejtën të dijë mënyrën sesi shpenzohen të ardhurat e komunës në tërësi dhe ato të programeve trevjeçare, në veçanti, e do të sigurohet duke përfshirë publikun në procesin e sigurimit të transparencës si:

- zhvillimin e takimeve konsultuese me publikun;
- bërja e anketimeve apo studimeve të ndryshme për marrjen e mendimit të publikut;
- bërjen publike të programeve dhe projekteve që përfshijnë ato
- sigurimit të pjesëmarrjes së publikut gjatë diskutimeve që organet përkatëse do të zhvillojnë për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve;

- bërjen e njoftimeve të ndryshme në mjetet e informimit publik apo në vend njoftimeve komunale për aktivitetet ku mund të sigurohet pjesëmarrja e publikut;
- çdo masë tjetër e cila vlerësohet e nevojshme në përmbushje të këtij qëllimi.

ANALIZA SWOT

Përparësitë	Dobësitë- Mangësitë
1. Ekzistimi i ligjit për programet e veçanta për banim (03/L-164) të përcjellë me shumë Udhëzime Administrative; 2. Përpilimi i këtij programi; 3. Ekzistimi i parcellës për ndërtim të një ndërtese par banim social; 4. Ekzistimi i Data Bazës për regjistrimin dhe monitorimin e aplikuesve për Banim Social; 5. Numri i aplikantëve momental që kanë kërkuar banim; 6. Vullneti komunal për trajtimin e temës së Banimit Social;	1. Mungesa e një zyrtari për banim; 2. Mungesa e mirëmbajtjes së mjaftueshme dhe administrimit të ndërtesave në pronësi të komunës që përdoren për banim social; 3. Kosto e lartë e banimit; 4. Buxheti limituar vjetor komunal; 5. Mungesa e regjistrimit dhe monitorimit të aplikuesve për banim social
Mundësitë	Rreziqet

1. Emërimi i një zyrtari për Banim; 2. Lista e kërkuesve; 3. Interesimi i Qeverisë së Kosovës për të ndihmuar financiarisht; 4. Donatorët tjerë potencial; 5. Identifikimi i banesave private që mund të lëshohen për Bonus Banim; 6. Programe të përbashkëta me partneri ndërkombëtar në fushën e banimit; 7. Përdorimi i skemave të PPPsë;	1. Pandemia Covid 19 2. Rritja e numrit të kërkesave; 3. Mosrealizimi i programeve për mungesë të fondeve; 4. Niveli i lartë i varfërisë; 5. Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare; 6. Papunësia; 7. Trendi i rritjes së numrit të popullsisë; 8. Migrimi
--	---